



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË TREGJEVE PRODHUESE**

Aktiviteti i Autoritetit të Konkurrencës për periudhën janar-gusht 2019

Programit Buxhetor:

I. Kontroll i Përqendrimeve

Për periudhën raportuese, vendimet e Komisionit janë si më poshtë:

1. Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 580, datë 17.01.2019** “Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD Skopje”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimeve bankare. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e brendshëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

2. Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 581, datë 17.01.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Adria TopCo B.V. nga Summer BidCo B.V.” Tregu përkatës në këtë transaksion është lënë i hapur. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e jashtëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

3. Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 582, datë 17.01.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Grid SHPK nga BConnect SHPK”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimeve call center. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e brendshëm. Pjesa e kombinuar e tregut pas përqendrimit arrin në vlerën 4.71% duke mos krijuar shqetësime për konkurrencën në treg.

4. Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 590, datë 31.01.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Magneti Marelli S.p.A. nga shoqëria CK Holdings Co.,LTD.” Tregu përkatës në këtë transaksion është lënë i hapur. Ky transaksion

nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e jashtëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 5 Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 591, datë 31.01.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët të tre shoqërive të reja (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga LG Electronics Inc.dhe Lufthansa Technik AG. Tregu përkatës në këtë transaksion është lënë i hapur. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e jashtëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 6 Komisioni i Konkurrencës me **Vendimin Nr. 595, datë 19.02.2019** vendosi “Për mos klasifikimin si përqendrim të njoftimit mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë InfoSoft Business Solutions SHPK”.

Transaksioni ndodh në tregun e brendshëm.

- 7 Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 596, datë 19.02.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A” . Tregu përkatës në këtë transaksion është lënë i hapur. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e jashtëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 8 Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 598, datë 17.05.2018** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ALH Group SHPK nga shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH”. Tregu përkatës në këtë transaksion është lënë i hapur. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e brendshëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 9 Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 601, datë 21.03.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve nga shoqëria Skysea B.V. tek shoqëria

Tosk Energji SHA”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i furnizimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e brendshëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 10 Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 606, datë 19.02.2019** Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë”. Tregu përkatës në këtë transaksion është tregu i furnizimit dhe tregtimit të mishit për konsum njerëzor. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e jashtëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 11 .Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 610, datë 10.04.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i telefonisë celulare e telefonisë fikse. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e brendshëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 12 .Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 614, datë 02.05.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga Volkswagen Financial Luksemburg SA, Mobileye Vision Technologies Ltd dhe Champion Motors Ltd”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ofrimit të shërbimit të transportit privat nëpërmjet automjeteve vet-drejtuese. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e jashtëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 13 Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 615, datë 02.05.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft”. Tregu përkatës në këtë

transaksion është lënë i hapur. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e jashtëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 14 .Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 616, datë 02.05.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V.”. Tregu përkatës në këtë transaksion është lënë i hapur. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e jashtëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 15 .Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 619, datë 09.05.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët me funksione të plota (Joint Venture) nga Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.”. Tregu përkatës i produktit në këtë transaksion do të konsiderohet tregu i shitjes së automjeteve dhe pjesëve të këmbimit por duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit si edhe duke iu referuar praktikave më të mira të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës mund të lihet i hapur. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e jashtëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 16 .Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 621, datë 13.05.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Digicom SHPK nga shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK”. Tregu përkatës i produktit në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimeve me pakicë të komunikimeve elektronike, konkretisht tregu me pakicë i shërbimeve të internetit, telefonisë fikse dhe IP TV. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e brendshëm. Ky transaksion është rasti i një përqendrimi vertikal, ku ndërmarrjet pjesëmarrëse ushtrojnë veprimtari në nivele të ndryshme të zinxhirit të produktit. Pas realizimit të transaksionit pritet të ketë rritje të efektivitetit dhe

cilësisë së shërbimit, të mundësisë së transmetimit dhe shpërndarjes të kapaciteteve profesionale nga përdorimi i teknologjisë FTTH në Shqipëri.

- 17 .Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 622, datë 13.05.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK”. Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i importit të grurit, tregu i importit të miellit dhe tregu i përpunimit dhe tregtimit të miellit. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e brendshëm. Ai nuk do të sjell ndryshime domethënëse në tregun shqiptar. Pjesa e kombinuar e tregut pas përqendrimit nuk krijon shqetësime për konkurrencën në treg.

- 18 .Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 624, datë 31.05.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company”. Tregu përkatës në këtë transaksion është lënë i hapur. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e jashtëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 19 .Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 625, datë 31.05.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes 100% të aksioneve të shoqërive Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH nga shoqëria Mol Germany GmbH”. Tregu përkatës në këtë transaksion është lënë i hapur. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e jashtëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

- 20 Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin me **Vendimin Nr. 631, datë 20.06.2019** “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ProQuest Holdings LLC nga shoqëria A-PQ Holdings LLC”. Tregu përkatës në këtë transaksion është lënë i hapur. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përqendrimi ndodh në tregun e jashtëm. Ai nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

21. Komisioni i Konkurrencës me **Vendimin Nr. 648, datë 19.09.2019** vendosi “Për mos klasifikimin si përqendrim të njoftimit mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë Dia Vita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB dhe dhënien e rekomandimeve Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

Per disa nga Vendimet e dhëna, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur monitorimin e:

- Tregut të Subjekteve Financiare Jo Banke (Vendimin Nr. 537, datë 20.07.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të BFSE HOLDING B.V tek shoqëria AMRYTA CAPITAL LLP.”) për një periudhë 1 vjeçare.
- Tregut të shërbimeve spitalore (Vendimin Nr. 539, datë 24.07.2018 “Mbi ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Hygeia Hospital Tirana SHA nga Diagnostic and Therapeutic Centre of Athens, Hygeia S.A tek American Hospital Sha”.) për një periudhë 1 vjeçare.
- Tregu i shërbimeve bankare (“Mbi përfitim e kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të TIRANA BANK SHA nga PIRAEUS BANK SA tek BALFIN SHPK dhe KOMERCIJALNA BANKA AD SKOPJE” për një periudhë 1 vjeçare.
- Tregu i telefonisë celulare e telefonisë fikse (Vendimi Nr.610, datë10.04.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitim të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD” për një periudhë 1 vjeçare.

Drejtoria e Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve ka realizuar 6 procedura të vlerësimit të transaksioneve të cilat nuk kanë plotësuar kriteret e Ligjit Nr. 9121/2003 dhe autorizoheshin nga Komisioni i Konkurrencës.

Procedurat hetimore

- 1) Në kuadër të një studimi të realizuar në tregun e shërbimeve spitalore, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 552 datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në tregun e shërbimit spitalor”, po realizon procedurat hetimore në tregun e shërbimit spitalor.
- 2) Me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 592, datë 31.01.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”, sekretariati është në procedurë hetimore për katër bankat më të mëdha të sektorit bankar.

II. Monitorime Tregu:

1) Monitorimi i tregut te GLN

Ky treg vijon të jënë në monitorim të vazhdueshëm nga viti i kaluar. Duke qenë se ky treg përballet me hyrjen e nje ndërmarrje te re e cila ka fituar një pjesë të konsiderueshme tregu, atëherë për të parë zhvillimin e tregut pas kësaj hyrje të re, monitorimi do te vijojë

edhe për një periudhë 6- mujore të tregu të importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së për ngrohje dhe konsum familjar, e cila përfundon në muajin tetor 2019.

2) Monitorim i tregut të prodhimit, tregtimit me shumicë e pakicë, mbarështimit të pulave për mish dhe produktit pulë e freskët

Në bazë të një ankese të ardhur pranë Autoritetit të Konkurrencës, është duke u monitoruar tregu i prodhimit, tregtimit me shumicë e pakicë, mbarështimit të pulave për mish dhe produktit “pulë e freskët”, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, në shkelje të nenit 9 të ligjit 9121/2003, i ndryshuar. Ky monitorim përfundon në shtator 2019.

3) Monitorim i zbatimit të detyrimeve të dhëna KESH me VKK 644, dt. 31.07.2019, në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike.

Komisioni i Konkurrencës me VKK nr. 644 dt. 31.07.2019 “Mbi mbylljen e Hetimit paraprak të tregut të depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike dhe dhënien e detyrimeve KESH SHA”, vendosi mbylljen e procedurës hetimore dhe dhënien e detyrimeve ndërmarrjes nën hetim. Me qëllim vlerësimit e zbatueshmërisë së këtij vendimi nga ndërmarrja KESH, AK do të monitorojë ndërmarrjen KESH për një periudhë 1 vjeçare, e cila përfundon në korrik 2020.

III. Hetime Tregu:

1) Hetimi paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të grurit dhe miellit

Në përfundim të procesit të monitorimit, duke qenë se sjellja e ndërmarrjeve në tregun e importit dhe prodhimit të miellit në RSH, në këndvështrimin e nivelit të çmimit, cilësisë së prodhimit mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, KK, me vendimin nr. 551, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit”, ka vendosur hapjen e hetimit paraprak në këtë treg.

Gjate procedurës hetimore lindi nevoja për hetime të mëtejshme, prova dhe të dhëna shtesë nga ndërmarrjet prodhuese dhe importuese. Për këto arsye Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 612, Datë 19.04.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 551, datë 04.10.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit” vendosi zgjatjen e periudhës hetimore për administrimin e të dhënave për periudhën shtator 2018-mars 2019 për importin e grurit dhe të miellit.

Në përfundim të afatit të hetimit paraprak, KK me vendimin nr.643, datë 31.07.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas” ka vendosur hapjen e hetimit të thelluar në këtë treg, i cili përfundon në janar të vitit 2020.

Kjo procedurë është në fazën e mbledhjes së informacionit nga ndërmarrjet dhe institucionet e përfshira si DPD, DPT etj.

2) Hetimi Paraparak i tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto

KK, me vendimin nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak ndaj ndërmarrjes “Bankers Petroleum Albania” LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, vendosi hapjen e hetimit në këtë treg. Meqënëse në ankesat e depozituara nga ndërmarrjet është kërkuar dhe marrja e masave të përkohshme për ndërmarrjen Bankers, AK më datë 11.12.2018, realizoi një seancë dëgjimore me ndërmarrjet ankimese dhe ndërmarrjen Bankers. KK, me vendimin nr. 578, datë 20.12.2018 vendosi “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore, dhe Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, KK vendosë gjopa periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore. Për mungesë informacioni të vazhdueshëm me VKK Nr. 603, datë 21.03.2019 “Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”, është vlerësuar e nevojshme zgjatja e e periudhës së hetimit paraparak dhe periudhës nën hetim me 5 muaj, afat i cili përfundon në tetor 2019.

Kjo procedurë është në fazën e përpunimit të informacionit të administruar dhe hartimit të raportit hetimor.

3) Hetimi i përgjithshëm në Sektorin e arsimit të lartë

KK me vendimin nr. 573, datë 26.11.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin e arsimit të lartë me qëllim kryerjen e një analizë të plotë në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar, si nga IAL-të publike dhe ato private, si dhe respektimin e rregullave të konkurrencës në këtë treg. Gjatë procedurës së hetimit të përgjithshëm është kërkuar informacion nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si dhe nga Universitetet publike dhe private. Për shkak të kohës së shkurtër të mbetur në dispozicion nga momenti i depozitimit të informacionit të kërkuar me qëllim përpunimin e tij, afati i hetimit të përgjithshëm është ndryshuar me 5 muaj me vendimin nr.620, datë 13.05.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”, afat i cili përfundon në tetor 2019.

Kjo procedurë është në fazën e përpunimit të informacionit të administruar dhe hartimit të raportit hetimor.

4) Hetimi paraparak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike

KK me vendimin nr. 588, datë 28.01. 2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrembërimit të dispozitave të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Gjate procedurave hetimore KK çmoi se administrimi i raporteve të monitorimit të 3 procedurave të shitblerjes së energjisë elektrike të ndërmarrjes KESH SHA, dhe monitorimit të kontratave të depozitimit dhe devijimit dhe vendimmarrja e ERE mbi këto raporte është e domosdoshme për të siguruar një vendimmarrje objektive. Per kete arsye, me vendimin nr . 617, Datë 09.05.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 588, datë 28.01.2019 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit” Komisioni i Konkurrencës zgjati afatin e e heimit paraprak me 5 muaj. Me vendimin nr. 644, datë 31.07.2019 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA si dhe zbatimin e neneve 69 dhe 70 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar”, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur mbylljen e kësaj procedure hetimore.

5) Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018 nga ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK

KK me vendimin nr. 567, datë 07.11.2018, ka vendosur disa detyrimeve për ndërmarrjen EMS APO, monitorimin e sjelljes së kësaj ndërmarrjeje për një periudhë 1 (një) vjeçare, si dhe detyrimin e saj për të raportuar çdo 3 (tre) muaj pranë Autoritetit të Konkurrencës të dhëna lidhur me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi dhe marrëdhëniet me palët e treta. EMS APO, në respektim të pikës V të vendimit 567/2018, ka raportuar për 3 mujorin e parë pranë Autoritetit të Konkurrencës lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna sipas këtij vendimi.

Lidhur me zbatimin nga ana e ndërmarrjes EMS APO të rekomandimeve të dhëna, sa i përket tre mujorit të parë të monitorimit, KK me vendimin nr. 608, datë 10.04.2019, “Mbi detyrimin për zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018 nga ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK”, ka vendosur:

1. Të mos pranojë draft kontratën për kryerjen e shërbimeve të ngarkim-shkarkimit në terminalin lindor në portin e Durrësit, të paraqitur nga EMS APO.
2. Koncesionari EMS APO në çdo rast nënkontraktimi të shoqërive të ngarkim shkarkimit për të operuar në terminal, në zbatim të kontratës koncesionare, duhet të aplikojë kushte të njëjta bashkëpunimi për nënkontraktorët, si dhe të vendosura në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.
3. EMS APO për hartimin e draft kontratës, në respektim edhe të pikës I/b të VKK 567/2018, të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si Autoriteti Kontraktor, me qëllim nxjerrjen e një drafti të përbashkët.
4. EMS APO, në çdo raportim pranë AK-së, të paraqesë dokumente, prova, fakte për të vërtetuar deklaratimet e bëra prej saj lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dhëna sipas pikës III të VKK 567/2018.
5. Ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në pikën (III) të VKK 567/2018, ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, të ligjit nr. 9121/2003.

Kjo procedurë monitorimi përfundon në muajin nëntor 2019.

6) Hetimi paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të anijeve kontejnerike dhe aktivitetet e lidhura me to në terminalin e kontejnerëve Durrës”

Nga vlerësimi i ankesës pranë Autoritetit të Konkurrencës, të një shoqërie lidhur me faturimin e padrejtë të shërbimit e zbrazjes dhe mbushjes së kontejnerëve nga konçesionari DCT, KK me vendimin nr. 627, datë 13.06.2019 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të anijeve kontejnerike dhe aktivitetet e lidhura me to në terminalin e kontejnerëve Durrës” vendosi hapjen e hetimit paraprak në këtë treg për periudhën kohore nga 01.01.2018 deri më 30.05.2019.

Kjo procedurë është në fazën e vendimmarrjes së KK, pas hartimit të raportit të hetimit paraprak nga GP.